



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
ME RASTIN E SHËNIMIT TË 15-VJETORIT TË BETEJËS SË
LLAPUSHNIKUT, E MBAJTUR MË 10 MAJ 2013**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
POVODOM OBELEŽAVANJE 15. GODIŠNJICE BITKE NA
LAPUŠNIKU, ODRŽANE 10. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Mbledhjen solemne e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar zonja e zotërinj të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën plenare me rastin e shënimit të 15-vjetorit të Betejës së Llapushnikut.

Të nderuar deputetë dhe mysafirë të pranishëm, e ftoj deputetin Fadil Demaku, që në përfaqësim të propozuesit, ta marrë fjalën.

FADIL DEMAQU: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Krasniqi,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuara familje të dëshmorëve,
Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Pas rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, Beteja e Grykës së Llapushnikut ishte sfida më e madhe dhe më sprovuese e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në përballje me forcat pushtuese serbe.

Ishte organizimi i parë i sulmeve dhe luftimeve në një front të gjerë. Aty morën pjesë luftëtarët e orëve të para, ata që më pas ishin bartës të luftës çlirimtare në shumë beteja anekënd vendit, e shumë prej tyre tanimë janë dëshmorë të kombit.

Në atë kohë, organizimi i UÇK-së në tërë territorin e Drenicës dhe më gjerë ishte i ndarë në njësite me emrat që nënkuptonin diçka të përbashkët, me pozitën gjeografike, apo edhe me ndonjë cilësim tjetër. Në territorin e fshatrave përreth Grykës së Llapushnikut vepronte UÇK-ja e organizuar në njësitet “Pëllumbi”, “Guri”, “Çeliku” dhe “Lumi”, të cilat kishin filluar zgjerimin, forcimin dhe përgatitjet e nevojshme që të jenë në gjendje të përballen me forcat e armikut në atë rajon.

15 vjet më parë, më 9 maj 1998, që në mëngjes dukej qartë për lëvizjet e forcave armike në drejtim të Grykës, pasi një ditë më parë, më 8 maj 1998, njësitet e UÇK-së e kishin sulmuar një kolonë të forcave armike.

Forcat pushtuese serbe ishin të përcjella edhe nga helikopteri i tyre, që vazhdimisht sillej mbi territoret tona. Si dukej, i udhëzonte forcat e tyre në terren për çdo lëvizje të radhëve tona dhe vazhdimisht atakoheshim nga predhat e minahedhësve të kalibrave të ndryshëm, me ç’rast vështirësohej shumë depërtimi në pozicione më të favorshme, në afërsi të rrugës kryesore.

Këmbëngulja e pjesëtarëve të UÇK-së për t’u pozicionuar, pavarësisht rrezikut, ishte e jashtëzakonshme dhe këtë e bënim me sukses nga ora në orë.

Artileria e forcave pushuese serbe vazhdonte pandërprerë granatimin e gjithë fshatrave rreth Grykës së Llapushnikut. E gjithë popullata kishte dalë në rrugë. UÇK-ja ishte shpresa e vetme. Në fytyrat e tyre ishte i përzier entuziazmi për numrin në rritje të ushtarëve tanë, por dukej edhe shqetësimi për situatën tejet dramatike dhe të pasigurt.

Më kujtohet se si rrugët e fshatrave Krajkovë e Domanek ishin të mbushura me vetura, traktorë, qerre e shumë të tjerë në këmbë, si pleq, gra e fëmijë që kishin dalë siç kishin mundur nga shtëpitë. Ishin banorët e fshatrave të Grykës së Llapushnikut, që grasatoheshin pandërprerë, që lëviznin në drejtim të fshatrave Baincë, Tërdec e Abri për të shpëtuar nga granatimet dhe plumbat që nuk ndaleshin gjatë tërë kohës.

Artileria armike nuk e kishte asnjë pozicion të caktuar, nuk njihnin as ushtarët, as civilët, as shtëpitë. Gjithçka jona ishte në shënjestër të tyre. UÇK-ja ishte në një luftë krejtësisht të pabarabartë dhe me përgjegjësinë më të madhe për popullatën tonë aty. Prania e popullatës në zonën e luftimeve ishte vështirësi e jashtëzakonshme për UÇK-në, e në anën tjetër ishte epërsi e madhe për armikun.

Në të dyja anët e rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë ishin njësitet tona me një koordinim veprimesh për ta mbyllur grykën. Aty, për disa orë, zhvillohen luftime të ashpra, ku ushtarët tanë arrijnë t'i shkatërrojnë mjetet e blinduara të forcave armike, duke u shkaktuar humbje të konsiderueshme në radhët e tyre.

Gjatë gjithë kohës së luftimeve ka vazhduar ardhja e luftëtarëve tjerë nga të gjitha njësitet e territorit të Drenicës e më gjerë, me ç'rast pozicionet e UÇK-së vinin duke u forcuar gjithnjë.

Duke i parë humbjet e tyre, forcat pushtuese serbe dhe pamundësinë për të depërtuar tutje, në orët e pasdites fillojnë të tërhiqen.

Nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bie dëshmori Besim Halilaj dhe gjithashtu dhjetëra të plagosur. Ishte ditë me dhimbje dhe tejet e lodhshme, por qëllimi ishte arritur. Rruga Prishtinë-Pejë ishte arterie e këputur për forcat armike dhe UÇK-ja këtë e shfrytëzoi maksimalisht ditët në vazhdim.

Betejat e Grykës së Llapushnikut që nga 9 maji e deri në fund të korrikut ishin bërë pikëtakim i luftëtarëve më të shquar të UÇK-së në një arenë frontale përballë forcave okupatore, ku gjatë asaj periudhe armiku provoi edhe disa herë, duke e rritur numrin e mjeteve luftarake dhe të trupave të saj, por hasi në rezistencë të fuqishme dhe të organizuar.

Gjatë atyre betejave të lavdishme patëm edhe humbje të luftëtarëve të shquar, si Imer Alushani e Ali Zogaj, dhe disa luftëtarë tjerë të plagosur. Gjithashtu patëm të vrarë e të plagosur edhe nga radhët e popullatës sonë.

Rajoni përreth Grykës së Llapushnikut, gjatë gjithë luftës, deri në qershor 1999, ishte vatër e vazhdueshme e luftimeve. Gjatë atyre zhvillimeve, në periudha të ndryshme

kohore kanë rënë dëshmorë edhe dhjetëra luftëtarë të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rëndësia e Betejës së Grykës së Llapushnikut ishte vendimtare për UÇK-në në vazhdim. Më 9 maj 1998, kur UÇK-ja e merr nën kontroll magjistralen Prishtinë-Pejë në Grykën e Llapushnikut dhe e bën të pakalueshme për forcat pushtuese serbe, ishte ndër veprimet strategjike që kishte ndërmarrë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke bërë lidhjen fizike të territoreve të saj, duke e rritur mjaft hapësirën e kontrolluar dhe duke i krijuar mundësitë reale për një organizim shumë më të fuqishëm në të gjitha segmentet e saj.

Beteja e Grykës së Llapushnikut mbetet njëra nga betejat më të rëndësishme të UÇK-së, jo vetëm për trimërinë e sakrificën e pjesëtarëve të saj, ku aty kanë bërë rezistencë shumica e emrave më të shquar, por edhe për rolin e saj shumëdimensional që ka reflektuar për krejt luftën çlirimtare në ato rrethana. Gjatë asaj periudhe, sa kishte funksionuar kjo lidhje, UÇK-ja e ka arritur përparimin më të madh në shtrirje dhe fuqizim të saj, si për nga numri i pjesëtarëve, ashtu edhe për furnizimin e tyre me armatim.

Ishte krijuar korridori i lirë për të fuqizuar dhe furnizuar të gjitha zonat ku vepronte UÇK-ja në nivel të vendit. Dinamika rritet gjatë muajit qershor 1998, me një fjalë ndodh masivizimi më i madh i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Si rezultat i atyre zhvillimeve, gjatë asaj periudhe formohen dhe zgjerohen shumë njësite në shumë pjesë të territorit të vendit tonë për të kulmuar në gusht të vitit 1998 me një organizim të mirëfilltë ushtarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur lufta merr përmasa të mëdha, sidomos në rajonet e Drenicës, Dukagjinit, Llapit, Shalës e Pashtrikut.

Gjatë asaj kohe, UÇK-ja e ka rritur fuqinë e saj vepruese dhe gjithashtu rolin e saj imponues, si një faktor real dhe i respektuar edhe për opinionin e gjerë ndërkombëtar.

15 vjet pas atyre zhvillimeve të jashtëzakonshme, më shumë se fjalët tona të tanishme që mund t'i thurim me qetësi dhe koncentrim të mjaftueshëm, flasin emrat e dëshmorëve të kombit, të cilët lanë gjurmë të pashlyera në ato beteja.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me këtë seancë i nderon dëshmorët e kombit, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha betejat e Grykës së Llapushnikut, e nderon sakrificën e luftëtarëve të UÇK-së në ato beteja, i nderon të gjithë qytetarët e rënë, si burra, gra, pleq e fëmijë gjatë atyre betejave, i vlerëson të gjithë ata qytetarë të atyre zonave që gjatë gjithë luftës ishin të atakuar dhe ishin pjesë aktive e sakrificës së madhe, me gatishmëri të jashtëzakonshme, e me një qëllim të vetëm - gjithçka në funksion të luftës çlirimtare. Faleminderit!

(Duartrokitje)

(Drejtimin e mbledhjen e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar pjesëmarrës në këtë seancë,
Familje të dëshmorëve,
Veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Qytetarë të nderuar,
Derisa në shumë pjesë të Drenicës dhe në disa anë tjera të Kosovës, si në Anadrini e Dukagjin, kishte kohë që ishte legalizuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës nëpër fshatrat përreth magjistrale Prishtinë-Pejë, që përfshin territorin e Drenicës e të Llapushës, të Dukagjinit, zgjerimi i saj bëhej ende në forma të fshehura.

Mirëpo, ndër ngjarjet më të rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kanë lënë gjurmën e vet në historinë e luftës së fundit kanë qenë luftimet që janë zhvilluar në lagjen Gjergjicë të Arllatit dhe sidomos në Grykën e Llapushnikut, ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës i ka shkruar faqet e saj më të lavdishme.

Luftimet e përmendura janë të rëndësishme dhe karakteristike sidomos për efektet që ato arritën në thyerjen e mitit mbi pathyeshmërinë e policisë speciale të blinduar të armikut, e cila që nga viti 1981 në kontinuitet kishte vrarë, torturuar e frikësuar popullin e pambrojtur të Kosovës.

Njësitet, që i zhvilluan me një heroizëm të pashoq luftimet, ishin formacionet “Pëllumbi”, “Çeliku” dhe “Lumi”.

Pse janë të rëndësishme këto luftime? Janë të rëndësishme se këto luftime e mbyllën aksin kryesor të qendrës së Kosovës që e lidhte Prishtinën me Pejë. Ishin të rëndësishme se e krijuan një zonë të lirë të madhe, e cila lidhte komunikimin e formacioneve të ndryshme ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pothuajse në të gjitha zonat e saj të veprimt. Këto luftime ishin të rëndësishme edhe për faktin se duke e krijuar zonën e lirë, po krijonin mundësi të reja të organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mobilizimit dhe strukturimit të saj. Ishin të rëndësishme se mundësitë e qarkullimit nga një zonë në zonën tjetër ishin lehtësuar dhe komunikimi ndërmjet komandave të ndryshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishin lehtësuar. Ishin të rëndësishme se e krijuan lehtësinë për krijimin e një armatimi më masiv dhe më cilësor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjitha këto së bashku e përgatitën organizimin dhe qëndresën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me këtë edhe popullin shqiptar dhe qytetarët e Kosovës në luftën e tyre për liri.

Legalizimi i këtyre njësiteve do të bëhej më 8 maj, në fillim i njësitit “Pëllumbi”, e më vonë “Çeliku” dhe “Lumi”.

Më 26 prill 1998, nga pjesëtarët e njësitit “Lumi” e “Pëllumbi” në magjistrallen Prishtinë-Pejë, në mes fshatrave Gjergjicë dhe Balincë, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, është sulmuar një kolonë ushtarake e armikut. Ky ishte sulmi i parë i Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës mbi forcat ushtarake të armikut. Në këtë sulm armiku ka pësuar humbje njerëzore e materiale, kurse njësi i UÇK-së nuk pësoi dëme. Pas aksionit, ushtarët janë tërhequr në fshatin Negroc, në bazën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë kohë. Ishte e arsyeshme se armiku nuk do të pajtohej me humbjen e 26 prillit. Më 8 dhe 9 maj 1998, forcat e mëdha të armikut ia mësynë Gjergjicës dhe atje hasën në qëndresë të fortë nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më vonë, luftimet u shtrinë përgjatë Grykës, prej Gjergjicës deri në Grykën e Llapushnikut. Përveç njësiteve të përmendura, luftimet në Grykën e Llapushnikut morën pjesë edhe shumë luftëtarë të njohur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto luftime erdhi në ndihmë edhe njësi “Çeliku” dhe armiku u gjet i rrethuar dhe e kishte vetëm një mundësi - të tërhiqej prapa. Armiku pësoi humbje të konsiderueshme, kurse nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një i vrarë e dy të plagosur.

Në mëngjesin e 29 majit, armiku e sulmoi sërish Grykën e Llapushnikut. Sulmi do të jetë i rreptë, por edhe mbrojtja e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e tillë.

Mirëpo, për dëmet që ka pësuar armiku, në shenjë hakmarrjeje do të djegë shumë shtëpi në fshatin Vukoc. Po këtë ditë, është sulmuar dhe djegur Pokleku i Ri dhe janë zhdukur pa gjurmë rreth 10 persona.

Ishim të vetëdijshëm se armiku nuk do të hiqte dorë nga Gryka e Llapushnikut, nga arteria kryesore e Kosovës, e cila i lidhte Prishtinën, Pejën, Gjakovën, Rahovecin, Prizrenin nëpërmjet Klinës dhe Malishevës.

Çështja shtrohej se çka po ndodhte rreth këtij problemi, çka po përgatitej, apo më mirë të themi çka po përgatiste Serbia dhe cili do të ishte hapi i saj i ardhshëm. Në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po përpiqeshim t'i merrnim masat mbrojtëse, edhe pse mundësitë i kishim mjaft të kufizuara. Luftëtarëve u mungonin mjetet financiare, u mungonte logjistika, furnizimi, që ishte kryesisht klandestin dhe bëhej kryesisht përmes njerëzve dhe kafshëve.

Veç këtyre që u thanë, punët udhëheqëse e komanduese, por edhe sistematizimin e armëve po e pengonte parcializimi, si dhe dëshirat për ta armatosur më mirë njësitin tim, apo fshatin tim. Para këtyre rrethanave, ishte e domosdoshme kalimi në një organizim të ri më cilësor sesa ai që ishte bërë deri në atë kohë.

Për ngritjen cilësore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në të gjitha aspektet sigurisht se do të mësojë edhe armiku, prandaj edhe shpejton ta sulmojë derisa nuk e kishte përfunduar ende strukturimin. Sulmin më të fuqishëm ushtarako-policor në drejtim të Grykës së Llapushnikut armiku e mori më 25 korrik 1998, duke e angazhuar një makineri nga më të mëdhatë dhe më modernet që kishte përdorur deri atëherë në luftime. Armiku kishte grumbulluar qindra tanke, praga, autoblanda, transporte me mjete të motorizuara. Armiku kishte më shumë mjete të motorizuara sesa kishim armë dhe ushtarë. Sulmonte në të dy krahët e magjistrales Prishtinë-Pejë. Sulmi po bëhej nga të gjitha llojet e armëve, pa pushim.

Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bënë rezistencë heroike. Luftimet zgjatën 2 orë. Në vijën e parë të frontit po merrnin pjesë edhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të gjitha luftimet që janë zhvilluar në Grykën e Llapushnikut, ushtarët tanë kanë treguar guxim, profesionalizëm dhe cilësi të lartë.

Luftimet e përmasave të ngjashme pothuajse në të njëjtën kohë janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor Dollc - Kijevë dhe Mleçan - Cerovinë. Në këto pjesë dalloheshin njësitet “Alfa”, “Zogu” dhe “Korbi”, të përqendruara në fshatin Cerovik të Klinës, të cilat shpesh i kanë kthyer prapa sulmet e policisë armike.

Përgjatë këtij aksi rrugor janë zhvilluar luftime të ashpra, sidomos në Gllarevë dhe Rixhevë. Edhe në këto luftime humbjet e armikut ishin të konsiderueshme. Mbyllja e Grykës së Llapushnikut që njëra nga ngjarjet më të rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ndoshta bëri që Hollbruku ta alarmonte botërisht mbi çështjen e Kijevës, mbi çështjen e rrezikshmërisë së gjendjes në Kijevë. Çelësi i Kijevës gjendej në Grykën e Llapushnikut dhe në Dollc - Malet e Gllarevës. Mbyllja e Grykës së Llapushnikut, jo vetëm që e shndërroi tërë Llapushnikun në territor të lirë, por edhe një pjesë të madhe të Kosovës, dhe ishte urë ndërlidhëse e të gjitha zonave të lira të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përmasat e këtyre luftimeve mendoj se i kanë dhënë impulse të reja luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e kanë përgatitur terrenin për një mobilizim të ri të qytetarëve në Kosovë dhe luftime të tilla janë zhvilluar më vonë në çdo pjesë të Kosovës, e duke iu falënderuar këtyre luftimeve kemi arritur që ne të jemi sot në këtë sallë.

Prandaj, unë e shfrytëzoj rastin që edhe në emrin tuaj, të gjithë atyre luftëtarëve, të gjithë atyre dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës t’u thurim lavdi. Faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Të nderuar të pranishëm,
Kabinet qeveritar,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe me kaq i mbylлим punimet e kësaj seance përkujtimore. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*